



GUIDË UDHËZUESE MBI LEGJISLACIONIN PËR KRIJIMIN E NJË MJEDISI PA BARRIERA PËR PERSONAT E AFTËSI TË KUFIZUARA



**GUIDË UDHËZUESE MBI
LEGJISLACIONIN PËR KRIJIMIN E
NJË MJEDISI PA BARRIERA PËR
PERSONAT E AFTËSI TË KUFIZUARA**

Tiranë, Janar 2011

Botim i Fondacionit Shqiptar për të Drejtat e Personave me Aftësi të Kufizuar

RR. "Bogdani" (ish-A.Z.Çajupi), Pall "Enil" No.15 kat 3 Tiranë

Tel/Fax: +3554269426

www.adrf.org.al

E-mail: adrf@albmail.com

Financuar nga Civil Rights Defenders



HYRJE

Fondacioni Shqiptar për të Drejtat e Personave me Aftësi të Kufizuara ka përgatitur këtë guide me qëllim orientimin e specialistëve të fushës së ndërtimit dhe komunikimit për përgjegjësitë dhe detyrimet për realizimin e mjedisit të përshtatur për personat me aftësi të kufizuara. Kjo Guidë i shërben gjithashtu edhe personave me aftësi të kufizuara dhe familjarëve të tyre për t'u njohur me të drejtat dhe detyrimet ligjore që burojnë nga legjislacioni në fuqi dhe për t'i kërkuar të zbatohen ato.

Çfarë përfshin kuadri ligjor për realizimin e mjedisit të përshtatur

Ligji Nr. 10 119, datë 23.4.2009 “Për planifikimin e Territorit”
VKM Nr 1503, date 19.11.2008 “Rregullorja për shfrytëzimin e hapësirave nga ana e personave me aftësi të kufizuara”

Ligji Nr. 10 112, datë 9.4.2009 “Për administrimin dhe bashkëpronësinë në ndërtesat e banimit”

Cili quhet territor i përshtatur

Territor i përshtatur është territori, që ofron përdorim të sigurt, të barabartë e të pavarur nga të gjithë personat, përfshirë personat me aftësi të kufizuara ose grupe të veçanta, për të cilët janë të nevojshme zgjidhje teknike apo pajisje të veçanta. *Ligji “Për planifikimin e Territorit”*

Cilat janë barrierat mjedisore

Barrierat arkitektonike janë:

- a) pengesat fizike si burim vështirësish për lëvizjen e kujtdo dhe në mënyrë të veçantë të atyre që, për çfarëdolloj arsyeje, kanë një aftësi lëvizëse të kufizuar të përhershme ose të përkohshme;
- b) pengesat që kufizojnë ose pengojnë këdo në përdorimin komod dhe të sigurt të hapësirave, pajisjeve dhe pjesëve përbërëse;
- c) mungesat e mjeteve dhe e sinjalizimeve që lejojnë orientimin dhe njohjen e vendeve dhe të burimeve të rrezikut për këdo dhe në veçanti për personat me shikim apo dëgjim të kufizuar.

“Rregullorja për shfrytëzimin e hapësirave nga ana e personave me aftësi të kufizuara”

Ligji për “Planifikimin e Territorit” nën konceptin e “territorit të përshtatur:

Në ligjin “Për planifikimin e Territorit” çështja e realizimit të një territori të përshtatur për përdorim nga personat me aftësi të kufizuara:

- a) ka zenë vend në Qëllimin e ligjit duke theksuar krijimin e garantimin e territoreve, duke i dhënë përparësi mundësisë së banimit për të gjitha shtresat ekonomike e sociale, krijimit të infrastrukturës fizike të përshtatshme për lehtësim të përdorimit të sigurt të shërbimeve e komoditeteve publike, të transportit, komunikimit dhe infrastrukturës, përfshirë territoret e përshtatura.

.....

b) është pjesë e Parimeve të planifikimit të territorit që të garantohet mundësia dhe lehtësia e përdorimi të tij nga personat me aftësi të kufizuara

.....

c) përcaktohet si çështje e Rëndësisë kombëtare në planifikimin e territorit kërkesa minimale e përshtatshmërisë për lëvizje për personat me aftësi të kufizuar dhe kategori të tjera, që e kanë të nevojshme këtë gjë.

.....

d) është Detyrim për t'u përfshirë në rregulloret e ndërtimit që të përcaktojnë normat dhe kushtet teknike bazë, të detyrueshme të projektimit, zbatimit të punimeve, përdorimit, mirëmbajtjes, prishjes dhe heqjes së strukturave dhe zhvillimin e infrastrukturës publike, materialet, cilësinë dhe përdorimin e tyre, me qëllim, ndër të tjera, edhe zbatimin e rregullave për përshtatjen e strukturave e të territoreve për individët me aftësi të kufizuar, sipas përcaktimeve të këtij ligji dhe legjislacionit të fushës në fuqi.

.....

e) është një nga Objektivat e planifikimit vendor krijimi i kushteve normale e të arritshme të jetesës dhe i territoreve të përshtatshme për personat me aftësi të kufizuara.

Të njohim “Rregulloren për shfrytëzimin e hapësirave nga ana e personave me aftësi të kufizuara”

Rregullorja përbëhet nga dy pjesë kryesore:

Pjesa parë

A. Rregulla mbi Zbatimin e kërkesave për eliminimin e barrierave arkitektonike në banesat, hapësirat dhe shërbimet publike.

Pjesa e dytë

B. Rregullat teknike dhe standardet për garantimin e mundësisë së hyrjes, përshtatshmërisë dhe fushëpamjes në ndërtesa

Objekti i Rregullores është përcaktimi i kërkesave teknike për eliminimin e pengesave që përcaktohen si “barriera arkitektonike”.

Qëllimi i Rregullores është zbatimi i rregullave për eliminimin e barrierave arkitektonike në banesat, hapsirat dhe shërbimet publike.

Fushat e aplikimit të Rregullores përfshijnë:

- objektet e reja,
- objektet që rikonstruktohen,
- objektet që ndryshojnë destinacion,
- objektet publike egzistuese

Veprimi i Rregullores shtrihet në:

- zgjedhja e përshtatur e zonës së zhvillimit;
- në hapësirat e jashtme/ hapësirat dhe vendkalimet për këmbësor, trotualet, shkallët dhe platformat, shërbimet publike higjenike, dekori urban, parkimet, qarkullimin dhe qëndrimin e mjeteve në shërbim të personave me aftësi të kufizuar
- në hapësirat e brendshme / njësitë e mjedisit dhe përbërësit e tyre: dyert, dyshemetë, kornizat e jashtme, orënditë fikse, терминаlet e impjanteve, shërbimet higjenike, kuzhinat, ballkonet dhe tarracat, kalimet horizontale, shkallët, platformat, ashensorët, shkallet e shërbimit dhe platformat ngritëse, garazhdet
- Rregullorja përcakton se të gjitha strukturat e ndërtimit duhet të jenë në përshtatje me rregullat e arritshmërisë
- Rregullat e kësaj rregulloreje janë të detyrueshme për të gjitha llojet e ndërtesave

Në procedura Rregullorja përcakton:

- përjashtimet dhe zgjidhjet alternative, në rastet që për të respektuar normativa teknike të veçanta mund të krijohen barriera arkitektonike; në rast të një pamundësie teknike të faktuar lidhur me elementë të strukturës teknike të ndërtesës ose me elementë të planit territorial vendor apo kombëtar, etj. Për zgjidhje ofrohen mundësi alternative. Shmangia lejohet nga autoritetet kompetente.
- Përpunimet teknike që duhet të evidentojnë zgjidhjet projektuese dhe llogaritjet teknike të përshtatura që garantojnë respektimin e standardeve të percaktuara me këtë rregullore
- Verifikimet që duhet të bëhen nëpërmjet deklaratës së autorit të projektit që i bashkëlidhet projektit të veprës dhe nga administra, së cilës i kërkohet aprovimi, pranimi dhe vërtetimi i përputhjes së projektit, dhe që kryen vlerësimin dhe vërtetimin e konformitetit
- Azhornimi dhe modifikimi i rregullave, që kryhen nga një komision i përhershëm i ngritur me vendim të Këshillit të Ministrave, i cili zgjidh problemet teknike që rrjedhin nga aplikimi i kësaj rregullore, kontrollojnë ose përpunon propozimet për azhornimin ose modifikimin, si edhe nxjerr konkluzione për propozimet e azhornimit e rregullave specifike

Në shërbime të veçanta për përfitim publik i referohen:

- Objekteve si ndërtesat e institucioneve parashkollë, shkollë, përfshirë universitetet dhe institucione të tjera me interes shoqëror në sektorin e arsimit/ në strukturat e brenëshme dhe mjetet në përdorim të tyre.
- Mjeteve të transportit tokësor/ rrugor dhe hekurudhor, detar dhe ajror
- Shërbimeve të transportit tokësor/ rrugor dhe hekurudhor, detar dhe ajror
- Shërbimeve dhe mjetet e komunikimit telefonik

Pjesa e dytë

Rregullat teknike dhe standartet për garantimin e mundësisë së hyrjes, përshtatshmërisë dhe fushëpamjes në ndërtesa

Në pjesën e dytë përcaktohen si fusha të aplikimit të rregullave teknike dhe standardeve

ndërtesat private që ndërtohen të reja, rezidenciale ose jo; ndërtesat rezidenciale publike të finacuara nga buxheti i shtetit, që ndërtohen të reja; rishtrukturimet e ndërtesave private dhe publike; hapësirat e jashtme të ndërtesave të lartpërmendura në zonat e përcaktuara, në tre janë nivelet e cilësisë së hapësirave të ndërtuara: *Mundësia e hyrjes; Mundësia e shfrytëzimit, Përshtatshmëria.*

Kriteret e projektimit për arritshmërinë dhe të shfrytëzimit zbatohen në njësitë e mjedisit dhe përbërësit e tyre si dyert, dyshemetë, shkallët, ashensorët, ambientet higjienike, kuzhinat, etj; në hapësirat e jashtme si rrugë, parkime, etj; në sinjalistikë; në ndërtesat sociale si arsimore, sanitare, bamirësie, kulturore; selitë e ndërtesave që i nënshtrohen punësimit të detyrueshëm

Në standartet dhe zgjidhjet teknike përfshihen standartet funksionale dhe të përmasave, Njësitë e mjedisit dhe përbërësit e tyre, hapësirat e jashtme, ambientet e shërbimit, pajisjet, etj.

Relacioni teknik është element shumë i rëndësishëm i përcaktuar në rregullore. Relacioni teknik duhet të paraqesë në mënyrë të qartë zgjidhjet e projektit nga ana arkitektonike dhe llogaritjet konstruktive që garantojnë plotësimin e rregullave të mundësisë së hyrjes, të shfrytëzimit dhe të përshtatshmërisë. Për sa i përket përshtatshmërisë, zgjidhjet arkitektonike dhe llogaritjet

konstruktive duhen përshkruar në formë grafike në fletët e projektit. Relacioni teknik duhet të shoqërohet nga një lidhje e veçantë që të përmbajë zgjidhjet e veçanta arkitektonike, ndërtimore dhe të punimeve të parashikuara për t'u kryer në shërbim të heqjes së barrierave arkitektonike në nivelin e arritshmërisë dhe të zgjidhjeve të parashikuara, për të garantuar përshtatshmërinë e ndërtesës.

Në realizimin e rregullave për përshtatje duhet të respektohen elementët e përshtatjes sipas natyrës dhe qëllimit të objektit

Përfshirja e elementeve të përshtatjes në projekt kërkon që projektet e objekteve ndërtimore duhet të përmbajnë zgjidhjen teknike në të cilën përfshihen dhe elementët e përshtatjes dhe zgjidhja teknike paraqitet, sipas fazave të hartimit të projektit, në të njëjtën mënyrë si në projektin e ndërmjetëm, projektin përfundimtar dhe projektin final.

Në projektin e ndërmjetëm, projektin përfundimtar dhe projektin final zgjidhja teknike paraqitet me përshkrimin teknik dhe vizatimet për përshtatshmërinë, duke qenë pjesë e projektit arkitektonik, projektit ndërtimor, projektit elektrik dhe ujësjellës kanalizim.

Rregullorja përcakton ngritjen e një strukture të veçantë për pranimin dhe monitorim të zbatimit të saj.

Ligji Nr.10 112, datë 9.4.2009 “Për administrimin dhe bashkëpronësinë në ndërtesat e banimit”

Në Ligjin “Për administrimin dhe bashkëpronësinë në ndërtesat e banimit”, në nenin 40 të tij përcaktohet përgjegjësia dhe roli i pushtetit vendor në heqjen e barrierave në banesat egzistuese me kërkesë dhe për përdorim nga ana e personave me aftësi të kufizuara.

Cilat janë përfituesit e zbatimit të legjislacionit për përshtatshmërinë?

- Janë të gjithë personat me aftësi të kufizuara dhe familjarët e tyre,
- janë të moshuarit,
- janë fëmijët,
- janë nënat shtatzëna dhe me fëmijë,
- janë transportuesit e ndryshëm të ngarkesave,
- janë të gjithë personat që në momente të caktuara kanë nevojë për lehtësira në lëvizje dhe komunikim
- është e gjithë shoqëria.

